




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.Nr.150/2021

Datë: 26 maj 2021

**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK)**, në bazë të nenit 108, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 7, paragrafi 1, pika 1.14, të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, duke vendosur në çështjen disiplinore ndaj Bekim Avdimetaj, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Pejë-Dega në Deçan dhe ish gjyqtari i të njëjtës dege Nexhat Musaj, duke vendosur sipas Raportit të Panelit Hetimor Nr.AD/KGJK/01/GJTHPE-ADGJTHPE.nr.20/20, të datës 28 prill 2021, në pajtim me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtareve dhe Prokuroreve, nenin 19 dhe 20 të Rregullores 05/2019, për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, në seancën dëgjimore, të mbajtur me 26 maj 2021, nxjerr këtë:

## V E N D I M

### I.

1. **Bekim Avdimetaj**, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Pejë-dega në Deçan, është përgjegjës për shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 5, paragrafi 2, pika 2.7, të Ligjit për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokuroreve.
2. Për këtë shkelje disiplinore Gjyqtarit Bekim Avdimetaj i shqiptohet sanksion disiplinor **Zvogëlim i përkohshëm i pagës prej tridhjetë përqind (30%) për periudhë prej gjashtë (6) muaj.**

### II.

1. **Nexhat Musaj**, ish Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Pejë-Dega në Deçan, është përgjegjës për shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 5, paragrafi 2, pika 2.7, të Ligjit për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokuroreve
2. Për këtë shkelje disiplinore ish Gjyqtarit Nexhat Musaj i shqiptohet sanksion disiplinor **Vërejtje publike me shkrim.**

## A r s y e t i m

Paneli hetimor i themeluar me vendimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, KGJK.nr.12.2021, të datës 26 janar 2021, për lëndën disiplinore me numër Nr.AD/KGJK/01/2021/GJTHPE-AD/GJTHPE.nr.20/20, të datës 28 prill 2021, i ka paraqitur Këshillit Gjyqësor të Kosovës raportin

me shkrim lidhur me hetimin e bërë për shkelje disiplinore të pretenduara të Bekim Avdimetaj, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Pejë-Dega në Deçan dhe Nexhat Musaj, ish Gjyqtar i të njëjtës degë të Gjykatës.

Për ta shqyrtuar këtë çështje disiplinore KGJK-ja me datë 26 maj 2021, ka caktuar dhe mbajtur seancën dëgjimore ku morën pjesë kryesuesja e Paneli Hetimor, Diellza Hoxha dhe subjektet e këtij hetimi disiplinor.

Kryesuesja e panelit hetimor në fjalën hyrëse dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pas zhvillimit hetimor disiplinor bazuar në ankesën e [ ] për zvarritje të procedurës gjyqësore në lëndën C.nr.389/19, në të cilën lëndë ankuesi ka qenë palë paditëse, është vërtetuar se lëndën kontestuese C.nr.389/19, gjyqtari Avdimetaj e ka pranuar me datë 7.11.2019, ndërsa seancën përgatitore e ka mbajtur me datë 06.01.2020, dhe me aktvendim kishte caktuar ekspertin e gjeodezisë. Me datë 20.01.2021, pas një viti gjyqtari Avdimetaj kishte dalë në vend shikim se bashku me ekspertin dhe palët dhe këtë ditë ka urdhëruar ekspertin gjeodet që në afat prej shtatë (7) ditë të përpilojë dhe dorëzojë ekspertizën me shkrim. Vonesën prej një viti gjyqtari Avdimetaj e ka arsyetuar me vonesë të dorëzimit të ekspertizës nga ana e ekspertit të gjeodezisë.

Pretendim për zvarritje të lëndës ankuesi ka pasur edhe në lëndën C.nr.81/19, për rregullim të megjes, e cila lëndë i është ndarë ish gjyqtarit Musaj, tani i pensionuar. Edhe ish gjyqtari Musaj vonesën e procedimit të kësaj çështjeje e ka arsyetuar me vonesë të dërgimit të ekspertizës së gjeodetit [ ].

Subjekti i hetimit disiplinor gjyqtari Bekim Avdimetaj, në seancën dëgjimore ka deklaruar se arsyeja se pse ka ardhur deri të zvarritja e procedimit të lëndës C.nr.389/19, pengim posedimi, ka qenë vonesa e dërgimit të ekspertizës së gjeodetit [ ]. I njëjti ka deklaruar se për shkak të pandemisë disa herë e ka thirr në telefon gjeodetin [ ] mirëpo nuk është përgjigjur. Më tutje, gjyqtari Avdimetaj ka deklaruar se me datë 26 janar 2021, ka nxjerr aktvendim me të cilin e ka dënuar me gjobë ekspertin [ ] për vonesë të ekspertizës.

Ndërsa subjekti i këtij hetimi disiplinor ish gjyqtari Nexhat Musaj, në seancën dëgjimore ka dhënë arsyet e njëjta për vonesë e procedimit të lëndës C.nr.81/19, rregullim i megjes.

Për vonesën e dërgimit të ekspertizës nga eksperti [ ] ish gjyqtari Musaj kishte nxjerr aktvendim për dënim me gjobë, mirëpo nxjerrjen e aktvendimit e kishte bërë pasi që Autoriteti Kompetent kishte kërkuar nga gjyqtari Musaj që të deklarohet lidhur me pretendimet e ankuesit [ ] në lëndën C.nr.81/19.

Për të vërtetuar këtë çështje KGJK administroi dhe i vlerësoi këto prova: Ankesën e ankuesit [ ]; Shkresat e lëndës C.nr.389/19 dhe C.nr.81/19; kërkesën për inicim të procedurës nga Autoriteti Kompetent; deklaratat e gjyqtarëve të dhënë me datë 30 dhjetor 2020 të dorëzuara tek Autoriteti Kompetent; raportet e lëndëve të kryera të subjekteve të hetimit, deklaratën e gjyqtarëve të deklaruar në seancën dëgjimore të datës 15 prill 2021; dëshmia e ekspertit të gjeodezisë Faruk Ahmetaj e dhënë në seancën dëgjimore të datës 15 prill 2021; provat e paraqitura nga Gjyqtari Bekim Avdimetaj, procesverbalin i shqyrtimit kryesor, aktvendimin e datës 02 mars 2021 si dhe flet dërgesën si dëshmi që palët kanë pranuar aktvendimin; procesverbalin e shqyrtimit të fundit të cilin e ka mbajtur gjyqtari Nexhat Musaj në lëndën C.nr.81/1.

Pas vlerësimit të këtyre provave një nga një dhe të gjitha së bashku, KGJK konstatoi se gjyqtari Bekim Avdimetaj ka bërë shkeljen disiplinore nga neni 5, paragrafi 2, pika 2.7, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve kur duke mos marrë me kohë masat e duhura në raport me ekspertin e gjeodezisë [ ] ka lejuar të shkaktohet zvarritje në procedimin e lëndës C.nr.389/19 edhe pse e njëjta bie në grupin e lëndëve që kërkojnë trajtim urgjent. Nga provat e administruara u vërtetua se gjyqtari Avdimetaj më lëndën C.nr.389/19, ishte ngarkuar me 7 nëntor 2019, seancën përgatitore e kishte mbajtur me datë 6 janar 2020 dhe në ditën e njëjtë kishte dalë në vend shikim me ç'rast kishte urdhëruar ekspertin [ ] që për 7 ditë të përpilojë dhe dorëzojë me shkrim ekspertizën. Mirëpo edhe pse ekspertin nuk ja kishte dorëzuar me kohe ekspertizën gjyqtari Avdimetaj nuk kishte ndërmarr asnjë veprim duke lejuar kështu vonesë prej një viti në procedimin e lëndës. Po ashtu nga shkresat e lëndës u vërtetua se gjyqtari Avdimetaj kishte marrë aktvendimin për ta gjobitur ekspertin [ ] pasi që Autoriteti Kompetent kishte filluar iniciimin e procedurës disiplinore për këtë.

KGJK vlerësoj se gjyqtaret me qëllim të mos prolongimit të lëndëve në fjalë kanë pasur mundësinë e revokimit të vendimit me të cilin e kishin caktuar si ekspert gjeodeti [ ] dhe ta caktojnë një ekspert tjetër sipas listës së ekspertëve për tu angazhuar nga institucionet e sistemit të drejtësisë. Të njëjtët gjyqtar për vonesën e dorëzimit të ekspertizës nga eksperti Ahmetaj nuk e kishin njoftuar Kryetarin e Gjykatës në kuptim të Rregullores për emërimin e eksperteve gjyqësor.

Nga shkresat e lëndës po ashtu u vërtetua se edhe gjyqtari Musaj kishte vepruar në të njëjtën mënyrë me gjyqtarin Avdimetaj në lëndën rregullim mëgje me shenjen e rastit C.nr.81/19. Edhe ky ka caktuar ekspertin e njëjtë dhe kishte dalë në vend shikim ditën e njëjtë sepse pala paditëse ka qenë e njëjtë. Edhe gjyqtari Musaj ka lejuar zvarritje të procedurës për shkak se nuk ka ndërmarrë me kohe veprimet e nevojshme në raport me ekspertin. Po ashtu nga shkresat e lëndës u vërtetua se edhe gjyqtari Musaj kishte marrë aktvendimin për ta gjobitur ekspertin [ ] pasi që Autoriteti Kompetent kishte filluar iniciimin e procedurës disiplinore për këtë rast.

KGJK vlerëson se sjelljet e gjyqtareve Bekim Avdimetaj dhe Nexhat Musaj në rastin konkret përkundër pengesave që kanë mund të kenë janë shkelje disiplinore e përcaktuar në nenin 5, paragrafi 2, pika 2.7, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.


KGJK i shqyrtoj me kujdes masat disiplinore të parapara me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtareve dhe Prokurorëve dhe vlerësoj se në rastin e gjyqtarit Bekim Avdimetaj masa e zvogëlimit të pagës në shumë prej tridhjetë (30%) për gjashtë muaj është masë proporcionale në raport në shkeljen e bërë të gjyqtarit dhe se e njëjta do të shërbejë si masë për disiplinimin e gjyqtarit dhe si preventive për të tjerët.

Kurse për gjyqtarin Nexhat Musaj i cili tanimë është i pensionuar vlerësoj se si masë adekuate për të është masa e vërejtjes publike me shkrim.

Nga sa u tha me lartë e konform nenit 7, paragrafi 1, nën paragrafi 1.3, dhe nën paragrafi 1.2 si dhe paragrafit 2, të Ligjit nr.06/l-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtareve dhe Prokuroreve, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshilli Gjyqësor i Kosovës**  
**KGJK.Nr.150/2021, datë: 26 maj 2021**

**Skender ÇOÇAJ,**  
**Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës**



**Këshillë Juridike:**

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejt ankese brenda 15 ditëve, pas pranimit të vendimit drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme të Kosovës.

*Kopje e vendimit i dërgohet:*

- *Armend Berisha, Kryetar në Gjykatën Themelore në Pejë;*
- *Bekim Avdimetaj, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Pejë-dega në Deçan;*
- *Nexhat Musaj, ish gjyqtar në Gjykatën Themelore në Pejë-dega në Deçan;*
- *Arkivit.*